



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 116/13
Prishtinë, më 15.07.2013, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziri dhe Sevdije Lama.

Mungoi: Naser Osmani, Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Imba Rudaku dhe Arbëreshë Kosumi.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Besim Beqaj- Ministër i Financave, Qerkin Berisha- MF, Bedri Hamza- Guvernator, Sokol Havolli-BQK, Faton Ahmetaj-BQK.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtur te Komisionit, dt. 10.07.2013 dhe 11.07.2013;**
3. **Shqyrtimi i Raportit të punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2012;**
4. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve Politike, të ndryshuar dhe të plotësuar me Ligjin Nr.04/L-058;**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtur te Komisionit, dt. 10.07.2013 dhe 11.07.2013

Kryetarja theksoi se procesverbalet e dt. 10.07.2013 dhe 11.07.2013, miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2012

Kryetarja konstatoi se me ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës neni 28 parasheh që Banka Qendrore së paku një herë në vit të informoj Kuvendin mbi realizimin e politikave të saj, objektivat dhe këndvështrimet lidhur me treguesit real të ekonomisë. Në raport reflektojnë aktivitetet e saj, janë të paraqitura të arriturat e ekonomisë së vendit tonë, vlerësuar me një rritje 2.9% të Bruto Produktit të Brendshëm, arritjet në sektorin real dhe financiar, tregu i punës, niveli i papunësisë. Poashtu është i përfshirë edhe Raporti i auditimit të Pavarur të BQK-së.

Bedri Hamza konstatoi se raporti është përpiluar duke respektuar kërkesat e ligjit për Bankën Qendrore, Ligji, duke pas për qëllim që të ju ofrojmë të dhëna sa më analitike, më të detalizuara. Pjesë e këtij raporti janë edhe pasqyrat financiare të cilat janë të audituara nga Auditori i Jashtëm. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në vitin 2012 ishte faktor i rëndësishëm i Zhvillimit të vendit duke siguruar ruajtën e stabilitetit financiar si njërin ndër objektivat kryesor të këtij institucioni. Ekonomia e Kosovës përkundër vështirësive që karakterizuan Eurozonën gjatë vitit 2013 ka vazhduar me trend të rritjes së prodhimit të brendshëm Bruto, kontribus të kësaj rritje kanë qenë konsumi privat dhe publik përfshirë investimet publike. Veçori pozitive në sektorin e jashtëm janë remitencat. Sektori financiar i Kosovës krahas zgjerimit të tij ka vazhduar të mbetet i shëndetshëm stabil, asetet e sektorit financiar kanë arrit vlerën 3.8 miliardë €, me një ngritje vjetore 9.7% në veçanti sistemi bankar ka vazhduar me rritje të kredisë(norma vjetore 3.8%) vlera e kredisë 1.7 miliardë€ dhe depozitave(norma vjetore 8.6%) vlera e tërësishme 2.3 miliardë €, kurse sa i përket norma e kamatës ka pasur trend rënës prej 14.4% në vitin 2011 në 13.42% në vitin 2012. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte mbi nivelin e kërkuar rregullativ dhe nivelin e kënaqshëm të likuditetit. E tërë kjo ka rezultuar me profit neto të sistemit bankar 18.5 mil €. Asetet e kompanive të sigurimit janë rritur për 16.3 % kurse numri i polisave të shitura është rritur 25.1 %, fondi i kursimeve pensionale të Kosovës realizoj kthim pozitiv dhe rritje të çmimit për njësi të aksioneve të Fondit. Tregu bankar Kosovar përkundër vështirësive në Eurozonë vazhdon ti jetë joshës për investitorët e rinj. Sistemi bankar u pasurua me një bankë komerciale nga Turqia. Viti 2012 u karakterizua me aktivitete të rëndësishme për stabilitetin financiar dhe përgjegjësitë e BQK-së. Me aprovimin e Ligjit mbi bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet jofinanciare bankare janë aprovuar një numër rregulloresh që avancojnë edhe më tej afarizmin e këtyre institucioneve. Poashtu janë marrë një numër masash administrative prudenciale përfshirë ato të hetimit dhe ndalimit të aktiviteteve financiare të palicencuara. Karakteristikë e vitit 2012 është funksionalizimi i tregut të letrave me vlerë, finalizimi i përgatitjes për sistemin e pagesave në kohë reale dhe operacionalizimin e versionit të ri të regjistrit të kredive. Me FMN dhe Bankën Botërore është realizuar programi i vlerësimit të sektorit financiar. BQK-ja merr pjesë në ngjarje aktive të institucioneve financiare ndërkombëtare. Pritshmëria për vitin 2013 parashtrojnë nevojën për një kujdes të shtuar të institucioneve financiare

Sali Asllanaj vlerësoj se nga Raporti është vërejtur rënie të aktivitetit për 10% , me ligjin për bankat, institucionet mikrofinanciare është menduar që të zgjidhet ky problem, por ka pasur rënie të investimeve të huaja direkte, sa është kjo pasqyrë e krizës globale financiare? Si dhe rënie të eksporteve?

Xhevdet Neziraj vlerësoj se raporti teknikisht është i përgaditur mirë kemi të dhëna në sektorin makrofiskal dhe financiar. Tek roli i Bordit besoj që të bëjnë një analizë me detaje sesa parashihet rritje ekonomike sidomos në sektorin financiar lidhur me normën e kamatës së bankave, rolin e investimeve tek NVM, kurse të dhënat e tjera besoj që është një raport shumë i mire por të ardhmen të ketë parashikime më të mira.

Kryetarja në raport vërehen shënime më të detalizuara për institucionet mikrofinanciare, dy institucioneve mikrofinanciare i është revokuar licenca, për çfarë arsye i është revokuar licenca ?

Bedri Hamza sqaroj se me aprovimin e Ligjit për bankat dhe institucionet mikrofinanciare institucionet financiare jo bankare bazuar në situatën e derivuar nga mendimi i Gjykatës Kushtetuese kemi marrë vendim ta prodhojmë draftin e parë të ligjit, draft ky i sponsorizuar përmes Komisionit për Buxhet dhe Financa. Institucionet kanë mbikëqyrje, por problemi qëndron tek mënyra e regjistrimit të tyre çështja e kapitalit etj. Pavarësisht ecurive pozitive të Kosovës, trendit pozitiv të remitencave, investimet e jashtme direkte dhe modeli aktual ekonomik në Kosovë lidhen me çështjen e privatizimit. Roli i BQK-së nuk është vetëm raportimi për ecuritë e vitit paraprak por pasqyrimi i indikatorëve makroekonomik.

Albana Fetoshi pyet sa është diferenca në mes të eksporteve dhe importeve?

Bedri Hamza sqaroj se deri në muajin prill vlera e eksporteve ka qenë 95.1 mil euro kurse vlera e importeve ka qenë 697.1 milion euro. Eksportet në përqindje janë rritur 20.2 % kurse importet 3.6 %. Është inkurajues fakti se në strukturë të importeve pjesëmarrja e makinerive, pajisjeve është 15.6%, kemi përmirësim të deficitit të llogarisë rrjedhëse në tre mujorin e parë të vitit 2013 kemi rënie vjetore 35.8%, IHD kanë një rritje 6.8%, remitencat kanë një rritje 7.8%. Sa i përket mbikëqyrjes revokimi i licencave është bërë për shkak të shkeljes së rregullorës që e rregullon këtë fushë, pjesëmarrja e vogël e aktivitetit të tregut.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë :

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2012.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve Politike, të ndryshuar dhe të plotësuar me Ligjin Nr.04/L-058

Kryetarja në vazhdimësi e sidomos nga shoqëria civile janë ngritur problemet rreth ligjit për financimin e subjekteve politike që konsideroj që ashtu siq ka qenë nuk ka qenë keq. Në pjesën e ligjit kish mjaftë shumë ndryshime, që është pak e vështirë të kalohet kështu siq kanë ardhë. Për më tepër në fillim kërkojm nga miistri të arsyetojë përmbajtjen e projektligjit.

Besim Beqaj nevoja për amendamentim ka ardhur prej rekomandimeve të komisionit Europian si pjesë e raportit për liberalizimin e vizave. Ligji i adreson tri çështje themelore në proces të plotësimit ndryshimit siç është: auditimi i pasqyrave financiare, ku pasqyrat të dërgohen në kuvend më Komisionin për Menaxhimin Financave Publike dhe Kuvendi të bëjë përzgjedhjen e disa kompanive të auditimit. Pjesa e dytë ka të bëjë me ndryshimin e dispozitave ndëshkimore ,ku duhet të specifikohen dispozitat ndëshkimore për partitë politike që e shkelin ligjin e zgjedhjeve. Pjesa e tretë ka të bëjë me një definicion më gjithëpërfshirës në lidhje me donatorët dhe donacionet , ku dispozitat e projektligjit e zgjerojnë bazën e donatorëve të ndaluar për financimin e subjekteve politike me qëllim të shmangies së praktikave korruptive , ato vendosin edhe afate kohore prej tre viteve për subjektet që kanë fituar nga institucionet që mos kenë të drejtë të jenë donatorë të subjekteve politike.

Albana Fetoshi ky projektligj që ka ardhur për financimin e partive politike është dukshëm më i mirë se parapraku. shumë zbrastira që kanë qenë në ligj tash me këtë ligj po plotësohen. Një vërejtje do ta kisha pas tek neni 11 të çështja e auditorëve, ku kufizohet vetëm tek Komisioni për Menaxhimin e Financave Publike për zgjedhjen e auditorëve. Konsideroj që nëse kjo vjen përmes Kuvendit atëherë nuk është në rregull që vetëm një komision mund ta bëjë përzgjedhjen. Edhe një vërejtje tjetër tek neni 12 paragrafi 11, ku konsideroj që fjala “mund” duhet të fshihet sepse në ligj nuk ka praktika ku fjala mund gjen hapsirë në ligje. Në ligje duhet të konstatojmë nëse në këtë rast i merret apo jo mandati por në mënyrën se si është shkruar kjo lë shumë hapsirë për keqinterpretim.

Xhevdet Neziraj kur partitë politike janë menaxhuar nga Kuvendi i Kosovës edhe atëherë ka ekzistuar auditimi, dhe me rastin e auditimit të Kuvendi janë audituar edhe subjektet politike dhe çdo pagesë është bërë nëpërmjet thesarit dhe ka qenë një kontroll shumë më strikte se sa tash që paratë shkojnë në xhirollogari dhe subjektet politike bëjnë pagesa të ndryshme. Komisioni Qendror Zgjedhor duhet me i rrit kapacitetet e veta sidomos në sektorin për subjektet politike dhe për shumë subjekte të bëjnë përmirësimin e tyre, për arsyeje se përveç subjekteve që kanë më tepër se tridhjetë deputet ka edhe subjekte që kanë një deputet. Një problem është edhe tek neni 18 që ka të bëjë me denimet, ku aq të rënda janë denimet ku një subjekt i vogël mundet krejt fondin e demokratizimit me ja marrë dhe nuk mund të krahasohet një subjekt që e ka një deputet me subjektet që kanë më tepër dhe tridhjetë deputet. Denimet duhet të jenë me përqindje me pjesëmarrjen e mjeteve nga fondi, ata që marrin më shumë para të paguajnë edhe me shumë.

Latif Gashi për këtë ligj ekziston një pajtueshmëri mes subjekteve politike, ekziston edhe një harmonizim me faktorin tjerë të bashkësisë Europiane, nuk e shohë të arsyeshme të hymë në detale dhe të flasim në emër të subjekteve politike ku dihet se kemi informacione se edhe liderët më të madh janë marrë me këtë. Tek neni 12 paragrafi 11 mendoj që duhet të riformulohet që në terme juridike nuk ka fjalë mund, konsideroj që fjala mundë duhet të hiqet.

Kryetarja a ka mundësi që Ministria e Financave të na tregojë ku e kanë marrë këtë praktikë, cili vend e ka një praktikë të tillë?

Sali Asllanaj nëse partitë politike mësohen ti menaxhojnë si duhet këto para që i marrin nga buxheti i Kosovës ka mundësi kur të vinë në qeveri me pas një kulturë me menaxhimin si duhet, prandaj kisha propozuar që këto sanksione ndoshta edhe të rritet. Tek çështja e donacioneve është pika ma e ndishme e çdo partie politike në financimin e saj ato nuk janë transparente fare.

Albana Fetoshi konsideroj që mënyra se si kish mu zgjedh ky problem që çështja e donacioneve që hiqet fare, të rritet fondi prej buxhetit dhe kështu të jetë më i kontrollueshëm.

Besim Beqaj ky ligj ka qenë pjesë e agjendës legislative të rregullt, tani në fund ka ardhë edhe si rekomandim i komisionit European për disa amendamente që kanë të bëjnë me llogaridhënien dhe transparencën e partive politike. Dy çështje i adreson ligjin një është çështja e parasë publike që vjen nga buxheti i Republikës së Kosovës që ju ndahet parive politike në mënyrë të rregullt dhe pjesa tjetër pranimi i donacioneve dhe evidentimi i donacioneve d.m.th vendos një rregull tek donacionet dhe ky ligj është harmonizuar edhe me partitë politike.

Kryetarja duhet të rregullohet çështja përzgjedhjes së auditorëve që është paraparë përmes komisionit të përbashkët të financave publike dhe përzgjedhjen ta bëjnë organet e specializuara që janë në kuadër të Kuvendit si dhe të bëjë përzgjedhjen e auditorit kjo të shkojë përmes komisionit të shpalljen e konkursit duhet ta bëjë Kuvendi dhe jo komisioni.

Qerkin Berisha në draftin fillestar të PL ne kemi propozuar që KQZ-ja të bëjë përzgjedhjen e këtyre auditorëve në baza vjetore, por momentin kur e kemi dorëzuar tek Komisioni Evropian për komente këtë na kanë dhënë vërejtje duke na rekomanduar që të ketë dispozitë që të ndryshohet, ose auditori i përgjithshëm ta bëjë auditimin e subjekteve politike ose edhe Kuvendi. Ne kemi analizu praktikën e rajoneve dhe kemi pa që në disa vende auditori i përgjithshëm e bënë auditimin e subjekteve politike, por megjithatë në rastin tonë, është kundërshtim me Kushtetutën sepse auditori i përgjithshëm e bënë auditimin e parasë publike dhe kemi propozuar Kuvendin pasi që nuk kemi pasur zgjidhje tjetër. Sa i përket fondi mbetet te KQZ-ja.

Kryetarja pyet a është rekomandim i Komisionit Evropian me qenë nga një auditor për një subjekt politike nuk mundet një auditor me i auditu të gjitha partitë politike ?

Qerkin Berisha sqaron se Komisioni Evropian ka thënë se duhet me përzgjedh më shumë auditor, nuk ka mundësi një auditorë me i përfshi të gjitha subjektet politike brenda vitit, shumë e vështirë sepse i ka afatet e limituara dhe do të ishte konflikt interesit që brenda një viti ti auditoj dy herë apo tri herë sepse ka raste se brenda viti ka edhe raporte të rregullta të partive politike, por edhe raporte të fushatës zgjedhore por ka mundësi se i njëjti auditorë të bëjë auditimin e të dy raporteve.

Kryetarja theksoj se nuk e shoh të arsyeshme se nëse nuk kemi firma të auditimit për me i plotësu kushtet për të bërë auditimin e më shumë subjekteve politike për njëherë nuk po me duket e arsyeshme. Nuk janë 10 parti politike por janë rreth 50 apo 60. Me rendësi vetëm subjektet politike që e shfrytëzojnë një subjekt nga niveli i buxhetit të Kosovës e nuk bazohen sa ka donacione apo nuk e ka as një mjet nga buxheti i Kosovës.

Hykmete Bajrami ne si komision për buxhet e financa ndihemi shumë të hendikepuar sepse nuk i kemi përfaqësuesit e Komisionit Evropian përball edhe me na shpjegu, kështu që shumë herë nenet na vijnë të servuara në këtë formë edhe ne nuk kemi mundësi për të bërë asnjë pyetje e përgjigje. Definitivisht nuk e kuptoj pse një komision i Kuvendit me e ba përzgjedhjen e auditorit, çfarë profesionistë jemi ne për me ba përzgjedhjen e auditorit kur kjo me qenë kompetencë e KQZ-së. Tash ne nuk e dimë se cili ka me qenë roli i Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike në përzgjedhjen e auditorëve, cili është roli i administratës? Më mirë është KQZ-ja sepse të gjitha partitë politike kanë përfaqësuesit e vet në KQZ, ne jemi organ legjislativ këto nuk duhen të jenë kompetenca tona nuk pajtohem absolutisht që kjo me qenë kompetencë e Kuvendit të Kosovës.

Latif Gashi realisht qëllimi i këtij PL është financimi i subjekteve politike, tash me konsultime të reja edhe me sugjerime të reja edhe nga shumë faktor tjerë na ka ardhur neve këtu konkretisht e kemi nenin 11 që e përshkruan kontrollin financiar. Këtu saktësisht thuhet se Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike i lejohet përzgjedhja e 10 auditorëve që po i kufizon edhe përzgjedhjen e auditorëve tjerë. Sa i përket Komisionit a është profesional apo jo i kemi edhe 12 paragrafë tjerë që gjatë Komisionit saktësisht e orienton në profesionalizëm edhe nuk mundet me dal jashtë këtyre rregullave të 12 paragrafëve tjera. Prapë qëndroj në mendimin tim se në PL ka një marrëveshje paraprake, jam shumë i bindur se janë marrë mendime edhe të organizatave tjera jo qeveritare faktorëve ndërkombëtare subjekteve politike edhe u arrit një konsensus për me shku në këtë formë.

Kryetarja theksoj se duke i njohur procedurat edhe rregullat e procedurave të prokurimit publike nuk mundem me u pajtu se një Komision që përbehet prej deputetëve me selektu dhe me u marr me

procedurat e prokurimit, nëse duhet me u marrë me procedura të prokurimit merret stafi apo edhe zyra e prokurimit le të bëjë përzgjedhjen por jo deputetët.

Pas diskutimeve, Komisioni nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve Politike, të ndryshuar dhe të plotësuar me Ligjin Nr.04/L-058.

Mbledhja përfundoi: 13:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj